


OMBUDSMANI SHKURTIMISHT

Ombudsmani është një **institucion i pavarur shtetëror**, i cili kujdeset për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Slloveni. Mandati i Ombudsmanit bazohet tek Kushtetuta e Republikës së Sllovenisë dhe tek Ligji mbi Ombudsmenin e të Drejtave të Njeriut. Që nga 24 shkurti 2019, si Ombudsman i të Drejtave të Njeriut të Republikës së Sllovenisë ka shërbyer **Peter Svetina**.

Ombudsmani **supervizon autoritetet dhe kufizon ndërhyrjen arbitrare** me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore:



Puna e Ombudsmanit është e shumëllojshme, prandaj kjo është edhe arsyeja përse përmbajtja e tij është e organizuar në mënyrën e mëposhtme:

Avokati i Fëmijëve mundëson që të dëgjohet zëri i fëmijëve në procedura ku ata janë të përfshirë.

Shërbimi i Ekspertizës i Ombudsmanit merret me ankesat nga individët, të cilët janë të mendimit se u janë dhunuar të drejtat e tyre të njeriut apo liritë e tyre themelore.



Mekanizmi Kombëtar i Parandalimit viziton burgjet për të kontrolluar se si trajtohen personat e burgosur me heqje të lirisë, dhe parandalon torturën dhe trajtime të tjera çnjerëzore.

Këshilli i të Drejtave të Njeriut është një organ konsultativ i Ombudsmanit. Me anëtarësinë e tij prej 16 personash, të cilët vijnë nga rangjet e shoqërisë civile, shkencës dhe autoriteteve shtetërore, Ombudsmani konsultohet për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.

Qendra për të Drejtat e Njeriut merret me promovimin, edukimin e të drejtave të njeriut, kryen hulumtime e analiza dhe përgatit raporte dhe merr pjesë në projekte ndërkombëtare.

ÇFARË PUNE KRYEN OMBUDSMANI?

Ai trajton një ankesë të kryer nga një individ.

Ai bën propozime, rekomandime, kritika dhe opinione:

tek një autoritet nga perspektiva e të drejtave të njeriut në një çështje në konsiderim e sipër, pavarësisht nga tipi apo niveli i procedurave përpara këtyre autoriteteve;

tek Qeveria ose Asambleja Kombëtare për ndryshime në ligje dhe rregulla të tjera;

tek autoritetet me qëllim që të përmirësojë funksionimin e tyre dhe marrëdhëniet me klientët; në raporte të rregullta dhe të posaçme, në të cilat ai paralajmëron për mangësi sistematike dhe raporte për gjetjet; në deklarata për shtyp dhe shfaqje publike.

Nën kushte të veçanta, ai i dorëzon Gjykatës Kushtetuese një ankesë konstitucionale ose kërkesë për të ndërmarrë një shqyrtim të kushtetueshmërisë dhe ligjshmërisë së regullave.

Ombudsmani përgatit raporte vjetore, në të cilat ai jep shumë rekomandime ndaj një numër autoritetesh shtetërore.

Ai prodhon raporte alternative për organizata apo institucione ndërkombëtare mbi situatën e të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor në Slloveni, si edhe bashkëpunon me organizata, autoritete e institucione të ndryshme ndërkombëtare.

ÇFARË NUK MUND TË BËJË DOT OMBUDSMANI?

Ombudsmani nuk është një autoritet qeverisës, prandaj edhe kjo është arsyeja përse nuk mund të ndërmarrë vendime ligjërish të detyrueshme:

Ai nuk mund t'i detyrojë autoritetet e tjera që të realizojnë rekomandimet apo pikëpamjet e tij;

Ai nuk mund të korrigojë parregullsitë në vend të autoritetit kompetent.

Ombudsmani nuk trajton çështje që janë duke u shqyrtuar nga gjykata apo procedime të tjera ligjore, përveçse kur ato përfshijnë vonesa të paarsyeshme apo abuzime të pastra të pushtetit.

Ombudsmani nuk ka juridiksion të drejtpërdrejtë mbi entitetet private dhe as mbi kompanitë që operojnë në sektorin privat.

Lëshuar nga: Ombudsmani i Republikës së Sllovenisë, Ljubjanë 2023



REPUBLIKA
E SLLOVENISË



INSTITUCIONI I
OMBUDSMANIT

KUR DUHET TË DREJTOHEMI TEK OMBUDSMANI I TË DREJTAVE TË NJERIUT?

Në rast se vini re padrejtësi, ushtroni të drejtat tuaja!

Ombudsmani i të Drejtave të Njeriut të Republikës së Sllovenisë, Dunajska cesta 56, 1000 Ljubjanë

Numri i telefonit pa pagesë: **080 15 30**

Adresa e e-mailit: **info@varuh-rs.si**

KUR DUHET TË KËRKONI NDIHMËN E OMBUDSMANIT?

Në rast se mendoni se ju janë dhunuar të drejtat tuaja të njeriut apo liritë themelore, ose në rast se ka ndodhur ndonjë parregullsi tjetër.

Në rast se një dhunim apo parregullsi është kryer nga:

Autoritet shtetëror

një njësi administrative, qendër e punës sociale, autoriteti i tatimeve dhe taksave, inspektoriat, Ministri, Asambleja Kombëtare, autoritet shtetëror tjetër ...,

bashki ose komunë, administrata e qytetit apo e bashkisë ose komunës, autoriteti i bashkisë ose komunës

Autoritet i qeverisjes vendore

Mbajtës i posteve publike

agjenci publike, dhomë me anëtarësi të detyrueshme.

SI TË PËRFITONI NDIHMËN E OMBUDSMANIT?

Dërgoni një ankesë në adresë të Ombudsmanit, e cila duhet të jetë:

- **ME SHKRIM:** (në gjuhën sllovene, ose në gjuhën tuaj të lindjes në rast se nuk e njihni sllovenishten) dhe
- **TË NËNSHKRUAR:** (ajo duhet të përmbajë edhe informacionin tuaj personal).

Ju mund ta shkruani ankesën vetë personalisht; juve nuk ju duhet asistencë e ndonjë juristi.

- 1 Shkruani në ankesë rrethanat dhe faktet e çështjes** (për shembull, kur ka ndodhur dhunimi, kush e ka shkaktuar atë), dhe jepni evidenca që kanë të bëjnë me rastin.
- 2 Mënyra më e lehtë për të dorëzuar një ankesë të plotësuar** është të gjeni formularin "Ankesë drejtuar Ombudsmanit" në pikën tonë të informacionit apo faqen tonë të internetit.
- 3 Përpara se të dorëzoni një ankesë, ju mund të kontaktoni me Ombudsmanin me pyetjet që keni nëpërmjet një numri telefoni pa pagesë, adresës së e-mailit, ose vetë personalisht.**


ÇFARË BËN OMBUDSMANI ME ANKESËN TUAJ?

Kur Ombudsmani merr një ankesë me shkrim nga një individ, ai:

- 1. e shqyrton ankesën** (në rast se nevojiten shpjegime të tjera shtesë, juve mund t'ju kërkohet që të dorëzoni materiale të mëtejshme;
- 2. shqyrton kompetencën e tij;**
- 3. vendos nëse ankesa është e justifikuar apo jo** (Ombudsmani zakonisht nuk merr në shqyrtim ankesa në rast se ka kaluar më tepër se një vit që nga momenti i dhunimit);
- 4. ekzaminon faktet dhe bazën ligjore** (Kushtetuta, aktet ligjore, ligjet, rregulloret në fuqi);
- 5. mund të kryejë kërkime tek autoriteti me të cilin lidhet ankesa**, me qëllim që të marrë në dispozicion çdo informacion shtesë të nevojshëm dhe opinionin e autoritetit;
- 6. mund të kryejë kërkime edhe tek autoritete të tjera**, në rast se e vlerëson që kjo është e nevojshme për trajtimin gjithëpërfshirës të ankesës tuaj;

Ombudsmani ndjek një procedurë autonome dhe të pavarur në të gjitha rastet. Për këtë qëllim, ai mund të marrë të gjithë informacionet e nevojshme, të shqyrtojë dokumentacionin dhe të ndjekë shqyrtime të lajmëruara apo të palajmëruara të informacionit.

- 7. Kur ai ka mbledhur të gjithë informacionin e domosdoshëm, ai paraqet gjetjet:**



- 8. në bazë të këtyre gjetjeve, ai mund të përgatisë rekomandime të posaçme** për autoritetin në lidhje me eliminimin e parregullsive sistematike, të cilat ai mund t'i përfshijë në raportin e tij vjetor në adresë të Asamblesë Kombëtare;
- 9. ai mund të informojë publikun në lidhje me gjetjet e tij** (identiteti juaj dhe informacioni juaj personal nuk do të bëhet publik).

PROCEDURAT E NDJEKURA NGA OMBUDSMANI JANË KONFIDENCIALE, PA PAGESË DHE INFORMALE

Disa shembuj të instancave në të cilat mund të ndihmojë Ombudsmani:

- Në rast se autoriteti **nuk e shpjegon (siç duhet)** vendimin e tij;
- Në rast se inspektorati apo administrata e bashkisë ose komunës **nuk siguron një udhëzim juridik** për një vendim të tij, duke e bërë atë kështu të paplotë;
- Në rast se qendra e punës sociale **e vonon një përgjigje apo vendim** për një të drejtë të caktuar;
- Në rast se ai është është **lajmëruar për një dhunim** të të drejtave të fëmijëve, apo të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, të huajve dhe grupeve të tjera të pamundura;
- Në rast se mendoni që **autoriteti ka dhunuar të drejtat tuaja** për:
 - një jetë private apo familjare,
 - siguri sociale,
 - mjedis të shëndetshëm jetese,
 - dinjitet dhe siguri personale,
 - barazi përpara ligjit (diskriminim),
 - lirinë e mbledhjes ose grumbullimit,
 - lirinë nga ndërhyrja në jetën private ose familjare,
 - rekursin ligjor ose mbështetjen ligjore..

Ombudsmani shërben në të njëjtën kohë si institucioni kombëtar për të drejtat e njeriut.

Që nga janari 2021, ai është kthyer në **institucionin kombëtar për të drejtat e njeriut me statusin A, në përputhje me Parimet e Parisit** të Kombeve të Bashkuara që i përkasin statusit të institucioneve kombëtare (1993), që do të thotë se ai plotëson të gjitha standardet ndërkombëtare të punës në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në Slloveni.



»Me qëllim që të ndërtojmë një botë ashtu siç e duam, p.sh. një botë më të durueshme, më të ndershme dhe më të qëndrueshme, do të na duhet që të vazhdojmë të investojmë aktivisht tek masat për eliminimin e mangësive që gërryejnë ushtrimin e të drejtave të njeriut dhe që, specifikisht, vendosin si pikësynime sërish tolerancën, pasionin dhe humanizmin.«

Peter Svetina
Ombudsmani i të Drejtave të Njeriut të Republikës së Sllovenisë